

VENDIM
Nr. 318, datë 15.5.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 61, DATË 3.2.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË PAJISJEVE MJEKËSORE TE
RIMBURSUESHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9/1, e vendimit nr. 61, datë 3.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9/1. Lista e pajisjeve mjekësore që do të rimbursohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për vitin 2019, për pacientët e grupmoshës 0–25 vjeç, është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për vitin 2019.

3. Ngarkohet Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Shtojca nr. 1

Lista e pajisjeve mjekësore të rimbursueshme që tregtohen në farmacitë e spitaleve

NR.	Emri i pajisjes	Emërtimi i pajisjes sipas regjistrimit të AKBPM	Njësia	Importuesi	Prodhuesi	Çmimi i tregtimit me shumicë/njësi në lekë, me TVSH	Çmimi i pacientit	Rimbursimi
1/1	Fisha Diabeti	Smart Chek II Blood Test Strips 200020091	Fishë	Euromed shpk	Major Biosystem Corp. 7F., No.186, Jian-Yi RD., Jung- He District 285 New Taipei City Taiwan	19	0	19
1/2	Fisha Diabeti	Blood Glucose Test Strips	Fishë	O.E.S Distrimed shpk	Hangzhou Sejoy Electronics & Instruments Co., Ltd. Building 2, No. 202, Zhenzhong Road West Lake Economy & Technology Zone 310030 Hangzhou China	19	0	19
1/3	Fisha Diabeti	Onetouch	Fishë	Megastore shpk	Lifescan Europe, A Div. of Cilag GmbH International Gubelstrasse 34 6300 Zug Switzerland	19.92	0.92	19
1/4	Fisha Diabeti	Aparat eBsensor; Fishe eBsensor	Fishë	Capo-Al shpk	Visgeneer Inc. No.335, Sec.6, Zhonghua Rd. 30094 Hsinchu City Taiwan	21	2	19
1/5	Fisha Diabeti	Contour Plus	Fishë	Trimed shpk	Ascensia Diabetes Care Holdings AG Peter Merian- Strasse 90, 4052 Basel Switzerland	40	21	19